

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

STUDIME MASTER – DREJTIMI KUSHTETUES ADMINISTRATIV



**FUNKSIONI I AVOKATIT TË POPULLIT SI MBIKËQYRËS DHE
MBROJTËS I TË DREJTAVE DHE LIRIVE INDIVIDUALE
(VËSHTRIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE DHE
MASAVE QE PROPOZON AVOKATI I POPULLIT)**

(Punim për Master)

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Luz N. Balaj

Kandidati:

Anduena Islami

Prishtinë, Dhjetor 2024

ABSTRAKTI

Duke pasur parasysh faktin se shoqëria kosovare për dallim nga vendet tjera ish socialiste ka kaluar një rrugë më ndryshe të tranzicionit politik dhe institucional për shkak të luftës që ka përfjetuar dhe më pastaj administrimit të saj pas lufte nga bashkësia ndërkombëtare edhe zanafilla e krijimit të institucionit të Avoktit të Popullit daton që nga fillimi i qeverisjes së administratës ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, respektivisht nga periudha e instalimit të misionit të UNMIKut në Kosovë në vitin 1999.

Në fillim, institucioni i Avoktit të Popullit në Kosovës edhe pse ishte themeluar kishte pak ndikim duke qenë se UNMIK-u ushtronte pushtet suprem, mirëpo pas shpalljes së pavarësisë, roli i tij erdhi duke u konsoliduar dhe fuqizuar dhe sot konsiderojmë se ky institucion është një autoritet i pa mohueshëm me ndikim në jetën shoqërore dhe politike të Kosovës.

Institucioni i Avoktit të Popullit është themeluar si instrument i posaçëm ligjor për të implementuar legjislacionin e aplikueshëm në fushën e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes së të drejtave të njeriut, me kompetenca të plota për trajtimin e të gjitha rasteve që ndërlidhen me diskriminimin, barazinë gjinore përfshirë edhe të drejtat e fëmijëve, parandalimin e tortures si dhe promovimin e mbrojtjes ligjore të të drejtave dhe lirve themelore për personat fizikë dhe juridikë.

Prandaj, qëllimi i këtij punimi për Master është që të shqyrtohen, analizohen dhe të arrihen në rezultatet e kërkuara për punën dhe në veçanti për rolin e Avoktit të Popullit si mbikëqyrës dhe mbrojtës i të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës të cilat paraqiten në formë të konkluzioneve dhe rekomandimeve në funksion të forcimit të rolit të Avoktit të Popullit në shoqërinë kosovare. Thënë ndryshe, objektivi kryesor i këtij punimi është që të analizojë kontributin e deri tanishëm të Institucionit të Avoktit të Popullit në Republikën e Kosovës si dhe ta rrij deri tek përfundimet dhe rekomandimet mbi mënyrën e avancimit të punës së këtij institucioni në të ardhmen, duke e vështruar problemin nga aspekti normativ lidhur me atë se çka

mund të përmirësohet në funksion të asaj që roli dhe ndikimi i Avokatit të Popullit të fuqizohet edhe më shumë në raport me Administratën Publike dhe Institucionet tjerë shtetërore në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: institucion, mbrojtja e të drejtave, avokat, liri, masa